



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 korrik 2019
Nr. ref.:RK 1401/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI111/18

Parashtrues

Dragomir Vlasačević dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,
AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Dragomir Vlasačević, Liljana Ivič, Slobodanka Savić, Slađana Paunović, Nataša Maksimović, Tihomir Bojković, Zlatica Nedeljković, Milorad Đokić, Desanka Nikolić, Slavica Janković, (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga Žarko Gajić, avokat nga Graçanica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-17-0519-0001/0003, të 15 marsit 2018.
3. Vendimi i lartpërmendur iu dorëzua përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 5 prill 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenet 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

7. Më 3 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
9. Më 19 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
10. Më 12 mars 2019, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që ta dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.

11. Më 15 mars 2019, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dorëzoi dosjen e lëndës por mungonte Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.
12. Më 20 mars 2019, Gjykata sërish kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që të dorëzon Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.
13. Më 22 mars 2019, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dorëzoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015, së bashku me ankesat kundër këtij aktgjykimi.
14. Më 5 prill 2019, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesve që t'i dorëzon të gjitha ankesat e paraqitura kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015.
15. Më 5 prill 2019, Gjykata njoftoi Agjencinë Kosovare të Privatizimit për regjistrim të kërkesës dhe po ashtu kërkoi që të dorëzon të gjitha ankesat e paraqitura kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, i 31 marsit 2015.
16. Më 12 prill 2019, Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzoi dokumente në Gjykatë por theksoi se dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me parashtruesit e kërkesës.
17. Më 23 prill 2019, përfaqësuesi i parashtruesve solli dokumente që edhe më herët kanë qenë në dispozicion të Gjykatës.
18. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesit e kërkesës kishin qenë punëtorë të ndërmarrjes shoqërore NSH "Gërmia" në Prishtinë.
20. Më 5 korrik 2007, filloi procesi i likuidimit të NSH "Gërmia". Në këtë drejtim, në të gjitha dokumentet me shkrim që u janë dërguar punonjësve, është theksuar që 5 korriku 2007 do të konsiderohet si dita e fundit e punës në NSH "Gërmia".
21. Më 20 maj 2008, ndërmarrja shoqërore NSH "Gërmia" është privatizuar.
22. Më 15, 16 dhe 17 dhjetor 2011, ishte publikuar lista përfundimtare e punëtorëve që kishin fituar të drejtën në pjesëmarrje në 20% të fitimeve nga privatizimi i NSH "Gërmia". Afati për dorëzimin e ankesave ndaj listës përfundimtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ishte caktuar 7 janari 2012.

23. Privatizimi ishte kryer në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, neni 10.4 përcakton se punëtorët që konsiderohen legjitim për pjesëmarrje në 20% të fitimit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të dëshmojnë: (i) janë punëtorë të regjistruar të ndërmarrjes shoqërore përkatëse në kohën e privatizimit; dhe, (ii) se kanë qenë në listën e pagave të ndërmarrjes shoqërore për jo më pak se 3 (tri) vite.
24. Parashtruesit e kërkesës nuk ishin në listën përfundimtare të punëtorëve që kishin realizuar të drejtën për të marrë pjesë në 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Gërmia".
25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit parashtruan ankesa në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme ndaj Listës përfundimtare të punëtorëve të cilët kanë realizuar të drejtën e pjesëmarrjes në 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Gërmia".
26. Më 31 mars 2015, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (Aktgjykim SCEL-11-0070-C0001/C0115) ka refuzuar të pabazuar ankesat e parashtruesve të kërkesës për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta ndaj 20 % të fitimeve nga privatizimi i NSH "Gërmia".
- (i) Për parashtruesin Dragomir Vlasačević, (C-0044/4) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka ofruar asnjë "dëshmi themelore" për të dëshmuar marrëdhënien e punës me NSH "Gërmia" të paktën deri në vitin 1999;
 - (ii) Për parashtruesen Liljana Ivić, (C-0044/5) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka dëshmuar se ka punuar në NSH "Gërmia" së paku 3 (tri) vite;
 - (iii) Për parashtruesen Slobodanka Savić, (C-0044/7) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;
 - (iv) Për parashtruesen Slađana Paunović, (C-0044/8) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nga viti 1996 deri 1998 ka punuar në NSH "Gërmia" porse më 8 dhjetor 1998 ka themeluar marrëdhënie pune të reja në një ndërmarrje tjetër dhe se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;
 - (v) Për parashtruesen Nataša Maksimović, (C-0044/13) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se dokumentet e dorëzuara flasin për një person tjetër dhe jo për parashtruesen e kërkesës dhe konstatoi se ajo nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për marrëdhënie pune në NSH "Gërmia".
 - (vi) Për parashtruesin Tihomir Bojković, (C-0044/16) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka asnjë dëshmi lidhur me të dhënat e përgjithshme të parashtruesit dhe se ai nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;

- (vii) Për parashtruesen Zatica Nedeljković, (C-0044/17) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se dokumentet e dorëzuara flasin për një person tjetër dhe jo për parashtruesen e kërkesës dhe se ajo nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;
 - (viii) Për parashtruesin Milorad Djokić, (C-0044/32) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se nuk ka asnjë dëshmi për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe se ai nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;
 - (ix) Për parashtruesen Desanka Nikolić, që ishte ankuar në emër të burrit të saj të ndjerë S. N., (C-0044/68) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme vlerësoi se ajo/ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për marrëdhënie pune në NSH "Gërmia" dhe se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13;
 - (x) Për parashtruesen Slavica Janković, (C-0084) Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se ankesa e saj ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor.
27. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme në pajtim me nenin 10.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dha këshillën juridike duke ua kujtuar se mund të paraqesin ankesë me shkrim brenda 21 (njëzetënjë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit me shkrim.
 28. Më 8 prill 2015, aktgjykimi i lartpërmendur iu dorëzua përfaqësuesit për të gjithë parashtruesit e kërkesës kurse për parashtruesen Slavica Janković iu dorëzua më 5 maj 2015.
 29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kanë parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe e kanë bashkëngjitur ankesën e 27 prillit 2015 dhe konfirmimin e pranimit të ankesës nga Posta e Kosovës, e cila ishte e 21 prillit 2015.
 30. Më 27 korrik 2017, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi AC-I-15-0062-A0033) kishte marrë vendim për të gjitha ankesat që ishin paraqitur lidhur me aktgjykimin e lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nuk kishte vendosur fare për parashtruesit e kërkesës. Çështja e mosvendosjes nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme për ankesën e parashtruesve përbën thelbin e kërkesës së tyre në Gjykatë dhe do të shtjellohet në paragrafët në vijim.
 31. Më 29 gusht 2017, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme ndaj aktgjykimit të lartpërmendur, duke theksuar se përmes postës në Prishtinë më 21 prill 2015 në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë. Ai shtoi se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017.

Për atë arsye, sipas përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës, është vendosur për një grup prej 5 (pesë) ankuesish gjersa për 11 (njëmbëdhjetë) ankues tjerë (parashtruesit e kërkesës), Dhoma e Posaçme nuk ka vendosur fare. Si dëshmi, përfaqësuesi i parashtruesve, ofroi: (i) Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017; (ii) kopja e vërtetimit të pranuar nga posta nr. 027570 e 21 prillit 2015 e lëshuar në Prishtinë. Në fund, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, kishte kërkuar që të merret një vendim meritore dhe që ata të përfshihen në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën në 20% nga privatizimi i NSH "Gërmia" në Prishtinë.

32. Më 15 mars 2018, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktvendim AC-I-17-0519-0001/0003) e hodhi poshtë të papranueshme ankesën e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme arsyetoi: "... Kolegji i apelit ka vërtetuar që aktgjykimi i kontestuar dërguar përfaqësuesit të ankuesve A0001 më 4 prill 2015, respektivisht 5 tetor 2015, derisa ankesat e parashtruara DHPGJS-së të 29 gushtit 2017, qartë janë jashtë afatit ligjor. Prandaj, në bazë të nenit 10 pika 6 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, ankesat e ankuesve hidhen poshtë si të papranueshme, kurse vërtetohet aktgjykimi i kontestuar".

Dispozitat ligjore relevante

UNMIK/Rreg/2003/13, 9 maj 2003, mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individit apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
34. Parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë: "... në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë [...] se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për

parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017”.

35. *Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: “Arsyetim i tillë, ligjërisht është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me arsyet e marrjes së aktgjykimit. Gjegjësisht, gjykata, gjatë procedurës, me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar AC-I-15-0062/A0033 të 27.07.2017, plotësisht e ka anashkaluar faktin që ankesa në aktgjykimin e shkallës së parë SCEL-11-0070-C44 të 31.03.2015, është parashtruar në kohën e duhur në përputhje me dispozitat e nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në afat prej 21 ditësh nga dita e pranimin dhe me këtë, ka mohuar të drejtën e palëve të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës, e cila garanton barazi para Ligjit, si dhe nenit 32 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën në mjet juridik të barabartë para Ligjit si dhe nenit 54 të Kushtetutës lidhur me nenin 6.1, me të cilin garantohet e drejta në gjykim të drejt dhe ligjin 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, me të cilin garantohet e drejta për mjetin efektiv juridik, gjë që në këtë rast nuk është garantuar, duke marrë parasysh që ankesa, deri më sot nuk është marrë në shqyrtim”.*
36. *Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: “Përfaqësuesi i autorizuar i tregon gjykatës që me trajtimin e kërkesës për gjetje dhe vendimmarrje sipas ankesës së paraqitur, si ankesën e paraqitur, gjykata ka krijuar pasiguri ligjore, duke marrë parasysh që me vendimet e përmendura vjen në përfundim që ankesa nuk ekziston fare si e paraqitur ndonjëherë dhe me të cilën janë shkelur të gjitha parimet e Ligjit, Kushtetutës dhe Konventës Evropiane e cila garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ashtu, me marrjen e këtij aktvendimi, parashtruesve iu është mohuar edhe e drejta në pjesën e 20% nga privatizimi, duke pasur parasysh që kjo e drejtë bie në konceptin e pasurisë e përfaqësuesi i autorizuar është i mendimit që parashtruesit posedojnë të drejtën në pagesën e kësaj pjese, duke marrë parasysh që në rastin e parashtruesve tjerë pas marrjes së vendimit përfundimtar AC-I-15-0062-A0033 të 27.07.2017, e gjendja faktike në procedurë dhe faktet e ofruara janë pothuajse identikë, kështu që përfaqësuesi i autorizuar është i mendimit që ka ardhur deri te shkelja e të drejtave për gëzim paqësor të pasurisë së garantuar me Protokollin 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut”.*

Pranueshmëria e kërkesës

37. *Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.*
38. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:*

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

39. Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që parashikon:

[Kërkesa individuale]

“1.Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike nëse pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“2.Individi mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-17-0519-0001/0003] e 15 marsit 2018 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
42. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

43. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.
44. Parashtruesit e kërkesës, specifikisht pretendojnë: *“... në të njëjtin zarf janë vënë dy ankesa të ndryshme me dokumentacion shtesë [...] se për shkak të vëllimit të lëndës dhe me siguri për shkak të ndonjë gabimi teknik ankesa për parashtruesit e kërkesës ka ngelur pa u vlerësuar me aktgjykimin e formës së prerë të Kolegjit të Apelit, AC-I-15-0062-A0033, të 27 korrikut 2017”.*
45. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë se për shkak të lëndës së tyre voluminoze, ankesa drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme “ka pasur mundësi të jetë ngatërruar” në shkresat e lëndës dhe kështu ka mbetur e pagjykuar. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të mosvendosjes sipas ankesës së tij, ka ardhur deri te shkelja e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
46. Ndërsa shkeljet e neneve të tjera 24 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6.1 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i arsyeton si pasojë e shkeljes së nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata do të lëshohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës.
47. Gjykata vëren se, në rastin konkret, barra e të provuarit bie mbi parashtruesit e kërkesës. Nga dokumentet e dorëzuara, parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të provojnë se mosgjykimi i ankesës së tyre nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, nëse ka pasur të tillë, mund t'i ngarkohet këtij të fundit.
48. Gjykata thekson se ka kryer shikimin e dosjes së plotë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe se në dosjen e plotë të rastit nuk është regjistruar ankesa, të cilën përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës pretendon se e ka parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015.
49. Gjykata po ashtu vëren se ankesa kundër aktgjykimit në fjalë nuk është regjistruar as pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila ishte palë kundërshtare në kontest, dhe e cila, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, i është drejtuar edhe atyre.
50. Më tej, Gjykata vëren se ka një mospërputhje ndërmjet pretendimit të përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës dhe gjendjes faktike bazuar në

dokumentet e dorëzuara me kërkesën nr. KI111/18. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës pretendon se më 21 prill 2015 ka paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit nr. SCEL-11-0070-C0001/C15, të 31 marsit 2015, kurse nga dokumentet e dorëzuara rezulton se ankesën kundër aktgjykimit në fjalë, figuron data 27 prill 2015. Ndërsa fletëkthesa, të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë, mbante datën e 21 prillit 2015.

51. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se ankesa për të cilën përfaqësuesi i parashtruesve pretendon se është dorëzuar në të “njëjtin zarf” së bashku me ankesën tjetër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme apo se për shkak të “vëllimit të lëndës” kjo e fundit është “ngatërruar” dhe nuk ka arritur ta vlerësojë ankesën e pretenduar.
52. Gjykata gjithashtu vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t’i përmbahet këtij parimi. (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
53. Në rastin konkret, duke i vlerësuar procedurat në tërësi, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi i 31 marsit 2015) kishte konstatuar se parashtruesit e kërkesës nuk i kishin plotësuar kushtet ligjore për t’u konsideruar punëtorë me të drejta ndaj 20% të fitimit nga privatizimi i NSH “Gërmia”. Kurse, në njërën anë, çështja e gabimit teknik që pretendohet se ka çuar te mosgjykimi i ankesës nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (Aktgjykim AC-I-1S-0062-A0033, 27 korrik 2017) nuk është provuar nga parashtruesit e kërkesës, derisa, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme ka konstatuar se ankesat e parashtruesve të kërkesës janë të paafatshme, në anën tjetër.
54. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesve të kërkesës iu është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ata kanë mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsideruan relevante për rastin e tyre; se atyre u është dhënë mundësia që të kontestojnë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tyre janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
55. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk

përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (*Ibidem*, rasti nr. KI118/17; po ashtu shih, rastin e Gjykatës nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).

56. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
57. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
58. Gjykata më tej vëren se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur – Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
59. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
60. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Artta Rama-Hajrizi